

pranohet si person qe i transferohen pjeset e kapitalit me perjashtim te rasteve kur vet shoqeria i blen pjeset.

Neni 16

Organet e shoqerise jane: Asambleja e ortakeve dhe administratorete.

Neni 17

Asambleja perbehet nga ortaket themelues te shoqerise.

Mbledhja e zakonshme e asamblese se ortakeve behet te pakten nje here ne vit dhe thirret nga administratori i saj.

Mbledhja e jashtezakonshme e asamblese behet mbi kerkesen e njerit prej ortakeve kerkese qe duhet te behet me shkrim. Mbledhja duhet te behet jo me vone se tre (3) jave nga dita e paraqitjes se kerkeses. Data e mbledhjes duhet t'u behet e ditur ortakeve jo me vone se nje jave pas paraqitjes se kerkeses. Kjo gje eshte e vlefshme edhe per oren dhe vendin e mbledhjes.

Neni 18

Vendimet merren nga Asambleja ne mbledhjen e saj. Por vendimet merren edhe pas konsultimeve me shkrim te ortakeve, ne rast se te dy ortaket miratojne me shkrim permbajtjen e konsultimit.

Neni 19

Çdo ortak ka te drejten e thirrjes se mbledhjes se Asamblese dhe te marri pjese ne vendime dhe disponon nje numer votash te barabarta me pjeset e kapitalit themeltar qe ai zoteron.

Nje ortak mund te perfaqesohet nga nje ortak tjeter ose nga nje person tjeter kur per kete ka autorizim me shkrim.

Vendimet e asamblese se ortakeve fiksohen ne nje proces verbal, ku firmosin ortaket dhe sekretari. Ne rastin kur ligji e kerkon ose kur organi ekzekutiv e gjykon te arsyeshme, procesi verbal i asamblese mbahet nga nje noter.

Neni 20

Vendimet ne Asamble merren me shumice votash, qofte edhe nga nje ortak i vetem qe ka me shume se gjysmen e pjeseve te kapitalit themeltar, me perjashtim te rasteve te parashikuara ne statut qe vendimet merren me miratimin e te gjithë ortakeve ose 3/4 te pjeseve te kapitalit themeltar.

Neni 21

Asambleja e ortakeve vendos per keto çeshtje:

- Percakton strukturen organizative te shoqerise.
- Zgjedh personin qe do te drejtoi shoqerine ( administratorin ) dhe kompetencat e tij.
- Emron ekspertin kontabel.
- Miraton raportin e administrimit, inventarin, bilancin dhe llogarite vjetore.
- Shperndan rezerven qe ka ne dispozicion.
- Vendos per prishjen e shoqerise.
- Ben ndryshime ne statut.

- Vendos per shkrirjen e shoqerise ne shoqeri te tjera.
- Vendos per zmadhimin e zvogelimin e kapitalit themeltar.
- Ne rastet e prishjes se shoqerise cakton likujdatorin dhe e shkarkon ate kur perfundon likujdimi.

- Aprovon planin e investimeve dhe financimeve.
- Vendos per punonjesit qe do te merren ne pune.
- Vendos per çdo problem tjeter qe vihet ne rendon e dites.

Vendimet per zmadhimin ose zvogelimin e kapitalit themeltar per prishjen e shoqerise ose shkrirjen e saj ne shoqeri te tjera per transferimin e kapitalit si dhe per rastet e tjera qe parashikohen shprehimisht ne statut behet me miratimin unanim te ortakeve.

Vendimi per ndryshime te tjera ne statut behet me miratimin e shumices se ortakeve qe perfaqesojne tre te katertat pjese te kapitalit themeltar.

#### Neni 22

Shoqeria drejtohet nga administratori i saj qe eshte: Lavdosh Celibashi dhe Stavri Prifti, zv. administrator.

#### Neni 23

Administratori ka keto kompetenca per te vepruar ne emer te shoqerise ne mardhenie me te tretet:

- Te kryei te gjitha veprimet e administrimit ne interes te shoqerise.
- Te zbatoje planin e zhvillimit dhe investimit dhe te gjitha orientimet e dhena nga mbledhja e partnereve ( ortakeve ).
- Te vazhdoje dhe te kontralloje zbatimin e marveshjeve te shoqerise.
- Te organizojne punen e personelit te shoqerise, te shperndaj detyrat, te kerkoj llogari per realizimin e detyrave brenda afatit te caktuar, te kerkoje zbatimin e rregullave te brendshme.
- Te organizoje mbledhjet e zakonshme dhe te jashtezakonshme te shoqerise.
- Te emroje asistentet e tij.
- Te neneshkruaj kontratat ne emer dhe per llogari te shoqerise dhe te garantoje realizimin e tyre. Te perfaqesoj shoqerine para te treteve ne gjyq dhe ne arbitrazh. Ata mund te autorizojne persona te tjere te veprojne ne emer te tyre.
- Te fiksoje rillogaritjen e personelit dhe te atij korespondent mbi bazen e kritereve dhe brenda kufijeve te aprovuara nga mbledhja dhe kontratat e punes.
- Te vendos edhe per te gjitha çeshtjet qe nuk jane ne kompetence te asamblese.

#### Neni 24

Administratori ka te drejten e firmes.

Administratori zgjidhet per nje kohe te pa caktuar dhe asambleja mund ta revokoj ne çdo kohe, me vendim te ortakeve qe perfaqesojne me teper se gjysmen e pjeseve te kapitalit themeltar. Per sikelje te ligjit administratori shkarkohet nga gjykata me kerkese te çdo njerit prej ortakeve.



Per probleme te veçanta administratori autorizon per ta perfaqesuar ate edhe nje person te trete.

Neni 25

Shoqeria merr persiper detyrimet qe rrjedhin nga aktet e administratorit edhe kur keto akte nuk perfshihen ne objektin e shoqerise. Por shoqeria nuk merr persiper pasojat ndaj te treteve kur ajo provon se te tretet e dinin qe akti i administratoreve e kalonte objektin e shoqerise ose kur te tretet nuk mund te injoronin kete akt ne rrethanat e dhena, duke patur parasysh faktin se vetem shpallja e statutit nuk eshte prove e mjaftushme.

Neni 26

Administratoreve, nuk u lejohet te kontraktojne ne çfardo forme qofte, te marrin hua te shoqeria, te japin pelqimin ne emer te saj per paradhenie, si dhe te behen dorezanes apo te garantojne ne emer te saj angazhimet ndaj te treteve.

Neni 27

Administratori eshte pergjegjes individualisht ose solidarisht, sipas rastit, ndaj shoqerise ose ndaj te treteve, per shkelje te ligjeve, per shkelje te statutit apo per faje te kryera gjate administrimit te shoqerise.

Perveç padise per shlyerjen e demit, ortaket kane te drejte te ngrene padi penale kunder administratoreve.

Neni 28

a) Ortaket gezojne keto te drejta kryesore:

- Administrimin e shoqerise ne perputhje me kontraten dhe statutin.
- Pjesmarrjen me rezultat te çdo forme te veprimtarise se shoqerise te parashikuar ne kontrate dhe statut.

Perveç te drejtave qe gezon si antar i asamblese se ortakeve ( ku merr pjese vet ose me ane te perfaqesuesve te tij) merr te dhena qe tregojne gjendjen ekonomiko-tregetare dhe aktivitetin e shoqerise, paraqet propozime per t'u shqyrtuar nga organet e shoqerise sipas kompetencave. Ortaket gezojne edhe ato te drejta qe ligji i parashikon.

- Secili ortak ka te drejte te heqi dore nga shoqeria, duke lajmeruar me shkrim vendimin e tij asamblese se ortakeve 3 muaj perpara.

Heqja dore nuk e liron palen nga detyrimet e marra persiper me perpara ndaj shoqerise, si dhe nuk anullon detyrimet e shoqerise ndaj pales.

Pala doreheqese duhet te afroje kuotat e saj ( te llogaritur me çmimin e tregut ne kohen e shitjes) ortakut tjeter dhe kur ky nuk e pranon kete blerje brenda 30 diteve, mund t'ja shesi te treteve por jo me çmim me te ulet se ai i afruar ortakut. Ne rastin e pamundesise se shitjes, pala doreheqese detyrohet te caktojte nje çmim me te ulet dhe shitja do te kryhet nga organet administrative te shoqerise.

b) Ortaket kane keto detyra kryesore:

- Te depozitojne kuoten e tyre dhe kuoten suplimentare ne perputhje me

kontraten dhe statutin.

- Ti japin shoqerise te dhenat e mjaftushme per perpunimin e çdo objekti te veçante lidhur me veprimtarine e saj.

- Te kryej te gjitha detyrat qe jane ngarkuar ne shoqeri per realizimin e objektivave dhe te funksioneve te shoqerise.

Neni 29

Ne rast se kapitalet e veta te shoqerise per shkak te humbjeve te konstatuara ne dokumentat financiare, rezultojne me te vogla se gjysma e kapitalit themeltar ortaket, ne rast se nuk rregullohet gjendja brenda 4 muajve, vendosin ose per prishjen e shoqerise ose per ndryshimin e statutit, per zvogelimin e kapitalit themeltar, me nje vlere jo me te vogel se ajo e humbjeve, duke patur parasysh edhe kerkesat e nenit 38 te ligjit per shoqerite tregetare.

Neni 30

Ortaket kane te drejte te caktojne nje ekspert kontabel, ne qofte se gjate veprimtarise se tyre do te plotesojne nje nga kushtet e nenit 65 te ligjit per shoqerite tregetare.

Ne rast kundershimi, çdo ortak ka te drejt te kerkoi ne rruge gjyqesore caktimin e nje eksperti per paraqitjen e nje raporti per nje ose disa veprime administrative.

Ne rast emrimi te eksperteve kontabel, ata do te kryejne veprimin e tyre ne pajtim me dispozitat e ligjit mbi shoqerite tregetare.

Neni 31

Per pasqyrimin e aktivitetit ekonomik te shoqerise administratori eshte i detyruar te mbaj dokumentacionin e rregullt financiar dhe regjistrin perkates sipas ligjit ne fuqi. Ai duhet te paraqes bilance periodike e vjetore si dhe deklaraten perkatese te te ardhurave dhe ti depozitoj ato ne organet financiare te juridiksionit ku ushtron aktivitetin shoqeria.

Neni 32

Ushtrimi i veprimtarise se shoqerise fillon me 1 janar e deri me 31 dhjetor te çdo viti. Ne fund te çdo viti behet inventari i pasurise se shoqerise. Perjashtimisht ushtrimi i pare i veprimtarise perfshim periudhen nga themelimi ligjor i shoqerise deri me 31 dhjetor te vitit qe themelohet shoqeria.

Pas mbylljes se llogarive ekspertet kontabel te autorizuar perpilojne situacionet financiare vjetore ne perputhje me dispozitat ligjore.

Neni 33

Ne mbyllje te çdo viti financiar, administratoret bejne raportin e administrimit inventarin dhe llogarite vjetore ne perputhje me dispozitat e legjislacionit ne fuqi per kontabilitetin.

Raporti i administratorit perfshin gjendjen gjate vitit financiar te kaluar, ndryshimet e parashikuara, veprimtarite e mundeshme qe jane zhvilluar nga data e

mbylljes se vitit financiar deri ne diten qe eshte hartuar ky raport.

Dokumentat vihen ne dispozicion te eksperteve kontabel te autorizuar, te pakten nje muaj para mbledhjes se asamblese.

Neni 34

Fitime neto te shoqerise do te konsiderohen fitimet qe rezultojne pas zbritjes nga te ardhurat bruto te te gjitha shpenzimeve qe kane lidhje me aktivitetin e shoqerise, detyrimet fiskale, sigurimet shoqerore, demtimet, pagat, amortizimet etj. ne perputhje me legjislacionin shqiptar.

Neni 35

Shoqeria krijon fondin rezerve dhe fonde te tjera te veçanta financimi. Perberja, shuma e pergjithshme, burimet per krijimin e fondit rezerve, perdorimi dhe rregullimi i çdo fondi te veçante caktohen nga administratoret, ne perputhje me legjislacionin shqiptar.

Ne perputhje me nenin 218 te ligjit " Per shoqerite tregetare" nga fitimi i rezervuar gjate vitit financiar lihet menjane nje shume me vlere 1/20 e cila destinohet per formimin e nje fondi " rezerve e domosdoshme".

Kjo lenie menjane nuk eshte e detyrueshme kur shuma e domosdoshme arrin 1/10 e kapitalit themeltar.

Neni 36

Shoqeria priset me kalimin e afatit te caktuar ne statut.

Shoqeria priset para afatit me vendim unanim te Asamblese se ortakeve kur njeri nga ortakët heq dore nga shoqeria, i cili ne kete rast duhet te njoftoi ortakun tjetër me shkrim 3 muaj para. Ne keto raste kapitali themeltar i transferohet ortakut tjetër, ne rast se ky i fundit i pranon ato.

Neni 37

Shoqeria nuk qohet e prishur kur kapitalet perqendrohen ne doren e nje ortaku te vetem.

Neni 38

Rastet e pavlefshmerise te shoqerise ose te nje akti qe ndryshon statutin si dhe bashkimi dhe ndarja e shoqerise behet me perputhje me dispozitat e ligjit per shoqerite tregetare.

Neni 39

Kur shoqeria priset ajo kalon ne likujdim dhe ne kete rast emertimit te shoqerise i shtohet shenimi " shoqeri ne likujdim e siper". Shoqeria edhe gjate procesit te likujdimit vazhdon si person juridik deri ne perfundimin e procesit te likujdimit.

Prishja e shoqerise eshte me pasoja ndaj te treteve vetm mbas publikimit te prishjes ne regjistrin tregetar.







- 8 -

Neni 40

Per te perfunduar procesin e likujdimit, Asambleja emron nje person si likujdues i cili perfaqeson shoqerine. Likujduesi perpilon bilancin financiar, likujdon tek te tretet detyrimet e shoqerise, shet aktivin e shoqerise dhe ndan tepricat ne dispozicion.

Likujdues mund te jete edhe njeri nga ortaket.

Ne rast se ortaket nuk kane mundesi te emrojne nje likujdues ai emrohet nga gjykata me kerkesen e çdo personi te interesuar.

Neni 41

Ne periudhen e likujdimit ortaket mund te njihen me te gjitha dokumentat e shoqerise ne te njejtat kushte si edhe me pare.

Neni 42

Ne perfundim te mbylljes se likujdimit, ortaket thirren qe te vendosin per bilancin financiar perfundimtar, per aktin e rregullshmerise, per administrimin nga ana e likujduesit dhe per heqjen e mandatit te likujduesit si dhe per t'u evidencuar mbyllja e likujdimit.

Dokumentat e mesiperme miratohen nga Asambleja me unanimitet.

Neni 43

Kur shoqeria likujdohet pasurite qe jane vene ne dispozicion te shoqerise me te drejte shfrytezimi u kthehen pronareve.

Mjetet financiare te fituara si rezultat i veprimtarise se shoqerise dhe fondet fillestare ndahen ndermjet ortakeve ne perpjestim me kuotat e vena, pasi te jene bere përgesat per kreditoret.

Neni 44

Ne rast se ortaket kane mosmarveshje me menyren e likujdimit te shoqerise, keto zgjidhen ne rruge gjyqesore, sipas dispozitave perkatese te parashikuara ne ligjin per shoqerite tregtare.

Neni 45

Shoqeria ka te drejte te punesoje punonjes qe i nevojiten per te ushtruat veprimtarine e saj. Punesimi behet sipas kushteve te percaktuara ne legjislacionin e punes te Republikes se Shqiperise, si dhe rregullave te vena ne kontraten e veçante te punesimit qe lidhet midis punedhenesit dhe punonjesit.

Shoqeria u garanton punonjesve kushte pune dhe mjete te nevojshme per realizimin e detyres qe kryejne.

Punemarresit jane te detyruar te ruajne sekretet e shoqerise, para te treteve.

Neni 46

Te gjitha problemet qe do te lindin gjate ushtrimit te veprimtarise private te kesaj shoqerie do te zgjidhen sipas rregullave te percaktuara ne statutin dhe legjislacionin ne fuqi ne Republikën e Shqiperise.

Kur mosmarveshjet nuk zgjidhen me mirekuptim, kompetente per zgjidhjen e tyre eshte Gjykata e Rrethit te Fierit.



- 9 -

Neni 47

Shoqeria çregjistrohet nga regjistri tregetar mbasi kryen te gjitha formalitetet e shperndarjes se saj.

Neni 48

Ky statut firmoset nga palet me vullnetin e tyre te lire.

O R T A K E T

LAVDOSH CELIBASHI      STAVRI PRIFTI

*[Handwritten signatures of Lavdosj Celibashi and Stavri Prifti]*

REPUBLIKA E SHQIPERISE

NOTERIA

*N. 347 RYM  
N. 148 kal.*

V E R T E T I M

Sot, me daten 9-6 .1995 ( netedhjet e pese), u paraqiten perpara meje noteres Z. Lavdosj Celibashi dhe Z. Stavri Prifti , me identitetin e lartepemendur, madhore dhe te afte per te kryer veprime juridike, te pa njohur prej meje, por per personin e tyre u sigurova nga leternjoftimet qe ata mbajne, te cilet deklaruan se statuti i mesiperem i redaktuar jashte kesaj zyre eshte ne perputhje me vullnetin e tyre te lite i cili pasi u lexua me ze u firmos rregullisht prej tyre. Sipas ligjit edhe une noteria e neneshkruaj ate.



NOTERE  
PUBLIKE  
KAMARA SHEHU  
EL 249 28

*[Handwritten signature]*



## VENDIM

Nr. 3 date 15.12.2005

### I ASAMBLESE SE ORTAKEVE TE SHOQERISE TREGTARE “ HARMONIA ” sh.p.k.

Ne asambleja e ortakeve te shoqerise tregtare “ HARMONIA ” sh.p.k. e perbere nga ortaket zz. Lavdosh CELIBASHI dhe Stavri PRIFTI ne mbledhjen e dates 15.12.2005 kemi vendosur :

- Miratimin e raportit te vleresimit per zmadhimin e kapitalit te shoqerise tregtare “ HARMONIA ” sh.p.k. te pergatitur nga eksperte Laureta FILIPI per zmadhimin e kapitalit themeltar te shoqerise ne masen 18.700.000 leke, i cili mbas zmadhimit behet ne masen 18.800.000 leke.
- Depozitim e ketij vendimi prane regjistrimit tregtar te gjykates.

Asambleja e ortakeve te shoqerise tregtare

“ HARMONIA ” sh.p.k.

Lavdosh CELIBASHI



Stavri PRIFTI



REPUBLIKA E SHQIPERISE  
NOTERIA E TIRANES  
Nr. 11181 Rep.

Tirane me date 16.12.2005

### VERTETIM

Vertetohet se vendimi i asamblese se ortakeve te shoqerise tregtare “ HARMONIA ” sh.p.k. u nenshkrua ne prezencen time nga ortaket zz. Lavdosh CELIBASHI dhe Stavri PRIFTI per identitetin e te cileve u sigurova nga dokumentet identifikuese, dhe une notere e vertetoj sipas ligjit.

NOTERE





**RAPORT I VEÇANTE**  
**I Eksperteve Kontabel te Autorizuar**  
**Mbi Zmadhimin e Kapitalit**  
**te shoqerise "HARMONIA" Sh.p.k.**



*Shoqerise "HARMONIA" Sh.p.k.*  
Me seli ne Fier

*Te nderuar zoterinj!*

Ne cilesine e Ekspertit Kontabel te Autorizuar, sipas kerkesave te ligjit nr. 7638 date 19.11.1992 "Per Shoqerite Tregtare", Ju paraqesim Raportin mbi projektin e zmadhimit te Kapitalit nga fitimet ne zbatim te vendimit nr. 2 date 30.06.2005 te Asamblese se Jashtezakoneshme te Ortakeve te shoqerise "HARMONIA" Sh.p.k.

- Ne kemi proceduar ne auditimin e operacioneve te dhena ne Raportin e Administratorit te shoqerise dhe konkluduam ne opinionet e meposhtme:
  1. Per shkakun e kryerjes se operacionit te zmadhimit te kapitalit me perfshirjen e fitimeve (te vitit 2004, te mbartura) nuk kemi verejtje.
  2. Menyra e zmadhimit te kapitalit me ane te nenshkrimin te pjeseve te reja me vlere nominale te njejte me ato ekzistuese dhe dhena e tyre ne menyre te barabarte Ortakeve te shoqerise jane konform ligjit nr. 7638 date 19.11.1992 "Per Shoqerite Tregtare".
  3. Operacioni i zmadhimit te kapitalit nuk cenon barazine e ortakeve.
  4. Sipas statutit te shoqerise "HARMONIA" Sh.p.k., kapitali themeltar eshte 100.000 leke, ky kapital eshte i ndare ne 100 pjese duke patur secili nga ortaket Z. Lavdosh Celibashi 50 pjese, Z. Stavri Prifti 50 pjese, vlere nominale e nje pjese eshte 1.000 leke. Projekti i zmadhimit te kapitalit evidenton qe shuma e fitimeve per operacionin e zmadhimit te kapitalit eshte 18.700.000 leke dhe parashikon krijimin e 18.700 pjeseve me vlere nominale te njejte me vleren e pjeseve ekzistuese, pra me 1.000 leke secila. Per shumen e fitimeve te caktuara per zmadhimin e Kapitalit, nenshkrimin e pjeseve te reja, vleren nominale te tyre nuk ka verejtje nga ana jone.